



REPUBLIKA E KOSOVËS – РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

**Mendimi konkurrues
i
gjyqtarit Robert Carolan**

në

Rastin nr. KI78/12

Parashtrues

Bajrush Xhemajli

**Vlerësimi kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës
së Kosovës, Pkl.nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012**

Pajtohem me mendimin dhe aktgjykimin e shumicës në këtë rast për të gjitha arsyet e dhëna në mendimin e shumicës dhe për disa arsye tjera.

Në këtë rast parashtruesi i kërkesës ishte akuzuar për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 5 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK). Ky ligj në mënyrë specifike parashikon:

“(1) Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik dhe rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha dhe me këtë i shkakton lëndime të lehta trupore personit apo dëm thelbësor material që tejkalon vlerën mbi 1.000 euro dënohet me gjobë apo me burgim deri në pesë vjet. (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet. (5) Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.”
(me theks të shtuar)

Para se të mund të dënohet për këtë veprë penale ndonjë i akuzuar për shkelje të këtij ligji penal duhet të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

(1) i akuzuari e ka shkelur ligjin mbi trafikun; dhe

- (2) akti(et) e të akuzuarit e kanë rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë;
dhe
(3) akti i të akuzuarit ka qenë “me përmasa të mëdha” apo ka qenë shkaktari kryesor i lëndimit apo vdekjes.

Ky ligj parashikon se mund të ketë shkaktarë të shumëfishtë të aksidentit të komunikacionit. I njëjti nuk e dënon apo nuk e bën të jetë penal një akt që thjesht mund të jetë një nga shumë shkaqet e një aksidenti të komunikacionit përderisa nuk është shkaku kryesor i aksidentit. Thjesht pakujdesia gjatë vozitjes së automjetit që rezulton me lëndim apo vdekje nuk është krim i dënueshëm me këtë ligj. Kjo pakujdesi duhet të jetë e “madhe” apo pakujdesi e rëndë për të ardhur deri te shkelja e këtij ligji.

Për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se sjellja e parashtruesit të kërkesës në vozitje ka qenë shkaktari kryesor i aksidentit gjykata e shkallës së parë si gjykatë për gjetjen e fakteve në rastin e parashtruesit ka qenë e obliguar të ekzaminojë të gjitha provat dhe të gjithë shkaktarët e mundshëm të aksidentit. Në këtë rast, gjykata e shkallës së parë nuk bëri një ekzaminim të tillë madje as pas kërkesave të vazhdueshme që parashtruesi ia drejtoi gjykatës së shkallës së parë për të bërë një ekzaminim të tillë. Në të vërtetë, eksperti i trafikut i caktuar nga gjykata në rastin e parashtruesit të kërkesës sinqerisht e kishte pranuar :

“Nga shkresat e lëndës kemi evidencë vetëm në lidhje me shkaqet subjektive, dmth. nga palët e përfshira në aksident, përderisa prova tjera siç janë rruga dhe mjetet që kanë shkaktuar aksidentin, nuk kemi. Unë vetëm kam analizuar shkresat e lëndës, nuk kam marrë pjesë në inspektimin e vendit të ngjarjes”

Sipas dëshmisë së ekspertit të trafikut janë tre faktorë që kontribuojnë në shkaktimin e aksidenteve të trafikut: (1) faktori njeri (2) faktori rrugë dhe (3) faktori automjet. Por eksperti i trafikut në raportin e tij në rastin e parashtruesit të kërkesës vetëm konstatoi faktorin njeri, dhe jo faktorin rrugë apo faktorin automjet edhe pse ai e pranoi se ekzaminimi i këtyre faktorëve shtesë do të ishte relevant për të nxjerrë një mendim përkitazi me shkaktarin e aksidentit dhe nëse ai shkaktar ka qenë “me përmasa të mëdha”. Për pasojë asnjëherë nuk u përcaktua nëse automjeti i parashtruesit apo automjetet e tre vozitësve tjerë të përfshirë në aksident kishin probleme të panjohura mekanike në kohën e aksidentit që kanë mundur të kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit. Asnjëherë nuk u përcaktua nëse kushtet e rrugës kanë mundur të kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit. Përveç kësaj, shpejtësia dhe sjellja në vozitje e vozitësve tjerë kurrë nuk u vërtetua me ekzaminimin e përplasjes dhe dëmit të shkaktuar automjeteve tjera të përfshira në aksident. Asnjë përgjigje në ndonjërin nga këto pyetje nuk u lejua që t’i parashtrohet gjykatës së shkallës së parë përkundër kërkesave të përsëritura nga parashtruesi për caktimin e një eksperti për të kryer një hetim dhe ekzaminim të hollësishëm në përpjekje për t’u përgjigjur këtyre pyetjeve për të konstatuar nëse parashtruesi i kërkesës ka qenë shkaktar i aksidentit “me përmasa të mëdha”.

Në përgjigje të kërkesave të përsëritura të parashtruesit për ekzaminim nga një ekspert tjetër gjykata e shkallës së parë theksoi:

“... gjykata konsideroi se raporti i ekspertit të komunikacionit dhe shpjegimi i dhënë nga eksperti i komunikacionit ishin të mjaftueshme për të konstatuar gjendjen faktike.”

Gjykata e shkallës së parë kurrë nuk dha ndonjë arsye se pse erdhi deri te ky përfundim madje edhe kur eksperti i trafikut i caktuar nga vetë ajo dëshmoi se faktori automjet dhe faktori rrugë mund të kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit automobilistik.

Në përmbyllje të gjykimit të tij në gjykatën e shkallës së parë më 23 nëntor 2010 parashtruesi i kërkesës e pranoi se ai kishte një pjesë të përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit, por kurrë nuk e pranoi dhe as nuk deklaroi se e kishte shkelur ligjin mbi trafikun se kishte rrezikuar jetën e njeriut apo pasurinë apo se sjellja e tij në vozitje ishte shkaktari “me përmasa të mëdha” i aksidentit që kishte rezultuar me vdekjen e një qenie tjetër njerëzore. Ai vazhdimisht ka këmbëngulur në pafajësinë e tij në lidhje me akuzat penale dhe vazhdimisht ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të caktonte një ekspert të trafikut për të ekzaminuar hollësisht të gjithë faktorët që kanë mundur të shkaktojnë aksidentin.

Disa kanë sugjeruar se pasi që parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar se sjellja e tij në vozitje ka qenë një shkaktar i aksidentit është jorelevant dhe i parëndësishëm fakti se gjykata e shkallës së parë ia ka refuzuar kërkesën për zhvillimin e një hetimi të hollësishëm nga eksperti i trafikut. Ky është një konkludim i gabuar. Parashtruesi i kërkesës nuk është deklaruar fajtor për akuzat dhe nuk e ka pranuar fajësinë ndaj akuzave. Nëse do të kishte vepruar ashtu, nuk do të kishte arsye për gjykim penal.

Pasi që gjykimi ka ndodhur, që të tri elementet e akuzës ndaj parashtruesit është dashur të provohen përtej dyshimit të arsyeshëm. Parashtruesi i kërkesës vazhdimisht ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të caktohet një ekspert i trafikut që do të mund të kryente një hetim të hollësishëm të aksidentit duke ekzaminuar të gjithë faktorët që kanë mundur të kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit dhe të nxjerrë një mendim ekspertit për shkaktarin e aksidentit. Kjo kërkesë vazhdimisht është mohuar, mohim ky që ka qenë cenim i të drejtave kushtetuese të parashtruesit në bazë të nenit 31.4 të Kushtetutës.

Disa kanë sugjeruar se kjo Gjykatë në mënyrë të palejueshme ka vlerësuar provat në rastin e parashtruesit të kërkesës. Edhe ky është një konkludim i gabuar. Kjo Gjykatë vetëm ka konkluduar se nga pikëpamja procedurale parashtruesit të kërkesës nuk i është lejuar që të paraqesë prova dhe dëshmitarë relevantë në gjykimin e tij. Pasi që parashtruesit nuk i është lejuar që të paraqesë prova të tilla, ai nuk ka pasur gjykim të drejtë siç kërkohet me Kushtetutë. Në të vërtetë, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka lejuar që një ekspert tjetër i trafikut të ekzaminojë provat, vendngjarjen dhe automjetet e përfshira pa një sqarim të arsyetuar, është pothuajse e pamundur që të vlerësohen provat në këtë rast. Rrjedhimisht kjo Gjykatë nuk është duke vlerësuar provat. Në të vërtetë është vetëm duke vlerësuar se a i janë cenuar të drejtat kushtetuese parashtruesit të kërkesës. Në këtë rast, ato të drejta i janë cenuar në mënyrë të vazhdueshme.

Robert Carolan
Gjyqtar
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës